

◇ **Nuk duhet të fajësojnë fëmijën për problemet e tij** dhe t'i thoni se nëse ai nuk dëshiron të shkojë në kopsht, atëherë ai është një fëmijë i keq dhe ju nuk do ja plotësoni më dëshirat e tij. Kjo është një nga mënyrat më të lehta për të bindur një fëmijë se ai është i keq dhe jeni në rrugën që mund të zhvillojë një sërë kompleksesh për tërë jetën. Fëmija nuk duhet të fajësohet, sepse ai është ende i vogël dhe nuk ka përvojë dhe njohuri, nuk mund të zgjidhë një çështje të vështirë dhe nuk di si të kontrollojë emocionet e tij.

STRATEGJITË PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES DHE PËRSHTATJES NË KOPSHT



Strategjia 1: Përgatitja e fëmijës për rutinat e reja. Flisni për tranzicionin, atë që do të mbetet e njëjtë dhe çfarë do të ndryshojë nga rutina e tij ditore.

Strategjia 2: Përpiquni të luani "role play" në shtëpi. Krijoni "aktorët" tuaj të preferuar dhe sajoni situata ku ato përjetojnë situata të ngjashme kalimi nga çerdhja në kopsht. Mos harroni të "veproni" strategjitë e përballimit, për shembull, "z. Elefanti ndihet i frikësuar. Pra, çfarë mund të bëjë ai? Ndoshta ai mund t'i thoshte mësuesit të tij..."

Strategjia 3: Përpiquni të mos tregoni shumë ankthin tuaj rreth ndryshimit.

Strategjia 4. Shkruani një tregim për ditën e tij të parë në kopsht, bashkë me fëmijën tuaj, ku personazhin kryesor të jetë vetë fëmija.

Strategjia 5: Vizitoni kopshtin sa më shpejt që mundeni këtë verë dhe merrni me vete dhe fëmijën tuaj. Merrni fotografi të kopshti, grupit dhe mësuesve të rinj nëse është e mundur.

Strategjia 6: Shih nëse mund të zbulosh disa shokë të grupit të fëmijës tënd dhe organizoni një takim me lojra argëtuese.

Strategjia 7: Nëse e mbani mend tregojini fëmijës tuaj se si jeni ndjerë kur keni shkuar në kopsht, çfarë shkoi mirë dhe çfarë jo. Në këtë proces është mirë që të përfshini dhe vëllezërit apo motrat e fëmijës të cilët kanë eksperiencën të mëparshme, vlen të theksohen eksperiencat pozitive.

Strategjia 8: Tregoji fëmijës që është një proces normal të kesh frikë dhe të ndjesh frikë, por do të ndjeheni çdo ditë e më mirë. Ju mund t'i komunikoni fëmijës tuaj se: "Shumë fëmijë ndjehen ashtu sikurse ti", në mënyrë që ai të kuptojë se nuk po i ndodh vetëm atij. Përpiquni të pranoni frikën e fëmijës suaj si të vërtetë dhe ofrojini atij siguri.



Adresa: Rruga e Barrikadave, Tiranë
Website: femijeetiranes.al
Facebook: Fëmijët e Tiranës



Bashkia Tiranë
Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe
Kopshteve

Kalimi i fëmijëve nga çerdhja në kopsht



Këshilla për prindërit

◇ Ç'DO TË THOTË PËR FËMIJËN TË SHKOJË NË KOPSHT?

Kalimi i fëmijës në kopsht shënon një ndryshim të madh në jetën e tij dhe e rëndësishme është të bëni çdo gjë të mundur për ta përgatitur atë. Dita e parë e fëmijës në një institucion parashkollor është një nga fazat më të rëndësishme në jetën e tij. Procesi i kalimit nga çerdhja në kopsht mund të jetë i qetë dhe i kënaqshëm për një fëmijë ose i frikshëm për një fëmijë tjetër. Mënyra se si ai reagon varet nga mënyra se si është rritur fëmija deri në atë moment.

Për fëmijën:

Për fëmijën kalimi nga çerdhja në kopsht mund të jetë emocionuese sepse fëmija po lëviz në diçka të re që të rriturit në jetën e tij e konsiderojnë të rëndësishme. Ai/ajo mund të jetë i shqetësuar për largimet nga njerëzit e njohur, rutinat dhe përballet me të panjohurën.

Për familjen:

Familja ndjehet krenare që fëmija i tyre po hyn në kopsht dhe do të ballafaqohet me sfida të reja. Po ashtu ka shqetësimin se si fëmija i tyre do të përballet me ndryshimin; nëse ai ose ajo do të jetë i suksesshëm nga ky ndryshim, gjë e cila do nxjerrë në pah rolin e tyre si prindër.

Për edukatorët e çerdes:

Kalimi i fëmijëve nga çerdhja në kopsht do të thotë t'ju thuash lamtumirë fëmijëve të cilët ato kanë kaluar kaq shumë kohë dhe i kanë parë tekta rriten ditë pas dite.

Për mësuesin e kopshtit:

Kalimi i fëmijëve nga çerdhja në kopsht do të thotë të përshtaten me një grup të ri fëmijësh. Ata shpresojnë që fëmijët që hyjnë në grupet e tyre do të jenë të gatshëm të jenë të suksesshëm në programin e kopshtit.

Mos u merakosni nëse vini re një përkeqësim të sjelljes së fëmijës suaj ose një kthim mbrapa tek një sjellje më fëmimore. Është e zakonshme për fëmijët që të shfaqin sjellje negative, rebeluese ose që të jenë të irrituar. Mund të jetë e vështirë kur pas një dite të tërë pa e parë fëmijën shikoni se si ai sillet keq kur kthehet në shtëpi. Disa nga arsytet e mundshme se pse një fëmijë refuzon kopshtin mund të jenë:

- ◇ **Ndryshim i menjëhershëm i ritmit të jetës.** Nëse më parë fëmija e dinte se cila ngjarje do të ndiqte, tani gjithçka është ndryshe. Është e nevojshme t'i bindemi rregullave të reja të pakuptueshme, të mësosh sjelljen në një ekip, të luash me lodra së bashku
- ◇ **Ushqimet, rutina dhe objektet e ndryshme nga mjedisi i shtëpisë.** Shije të reja ose ushqime të pazakonta, zhurmë në grup, shumë fëmijë - faktorë që mund të shkaktojnë refuzimin e kopshtit.
- ◇ **Refuzimi i mësuesit.** Nëse fëmija nuk e pëlqen mësuesin në ditën e parë, ky është një problem serioz. Fëmijët aktiv dhe të zhurmshëm si dhe aktiviteti i tepërt i tyre shpesh mund të çojë në konflikt me shokët dhe mësuesen. Mësuesja thjesht nuk ka kohë të mjaftueshme për të kuptuar thelbin e konfliktit që ka lindur.
- ◇ **Fëmija nuk është social.** Edhe nëse një marrëdhënie besimi krijohet me mësuesin ka situata kur fëmija nuk mund të përshtatet në ekip dhe preferon të mbajë veten të distancuar. Nevoja për të komunikuar me bashkëmoshatarët për secilin fëmijë është e ndryshme.

Mos harroni! “Ai është i lodhur, ka nevojë për vëmendje dhe dëshiron të riafirmojë një farë pushteti mbi ju. Kushtojini atij vëmendje të pandërprerë - uluni bashkë për të ngrënë ose për të biseduar mbi ditën që kaloi”.

ÇFARË MUND TË BËJ UNË SI PRIND?

Vizitoni kopshtin bashkë me fëmijën tuaj për t'i dhënë atij mundësinë për të parë ambientin. Vizitoni kopshtin me

fëmijën tuaj gjatë kohës që ka fëmijë të tjerë duke luajtur gëzueshëm. Shpjegoni atij se ç'do të ndodhë gjatë ditës.

Flisni për interesat e fëmijës dhe gjërat që ai do të pëlqejë atje. Flisni për aktivitetet e kënaqshme që ai do të bëjë, aktivitete që ai tashmë i bën edhe në shtëpi, si për shembull, vizatim, prerje dhe ngjitje letrash apo dëgjim historish. Tregojini atij mbi rutinën dhe strukturën e ditës në kopsht gjatë kohës në shtëpi: “Tani është kohë dreke dhe në kopsht do të ishe duke ngrënë drekë tani”.

Flisni bashkë rreth kopshtit dhe dëgjojani shqetësimet që ai mund të ketë. Përfshijeni atë në bërjen e pazarit për gjërat që do t'i duhen në kopsht.

Tregohuni entuziast dhe pozitiv. Mos ja kaloni shqetësimet tuaja fëmijës. Shpjegojani atij se mësuesja nuk do të ketë mundësi t'i kushtojë vëmendje të pandërprerë. Mund ta balanconi këtë duke i shpjeguar kënaqësinë e të bërit miq të rinj.

ÇFARË NUK DUHET TË BËJNË PRINDËRIT NËSE FËMIJA REFUZON TË SHKOJË NË KOPSHT!

- ◇ **Nuk duhet të injorojnë protestat e fëmijës.** Fëmija nuk po përpjetet të tregojë se ai është i keq, siç ju i pohoni kur ai qan, por ai është ende i vogël dhe e tregon pakënaqësinë dhe refuzimin në mënyrën që di. Prindërit duhet të dëgjojnë me kujdes, të shqyrtojnë me kujdes situatën dhe të ndihmojnë me autoritet dhe dashuri.
- ◇ **Nuk duhet të fajësojnë fëmijën për problemet e tij** dhe ti thonë se nëse ai nuk dëshiron të shkojë në kopsht, atëherë ai është një fëmijë I keq dhe ju nuk do ja plotësoni më dëshirat e tij. Kjo është një nga

DITËT E PARA NË KOPSHT!